



Datë 18.07.2024.

**PROCESVERBAL – TIPI KONTRATËS – PUNË
(PROCEDURË E HAPUR)
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM.**

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Rehabilitim i rrjetave metalike për 4 (katër) agregatët në veprën e marrjes së Hec Vau i Dejës dhe rehabilitimi i udhëzuesve të rrjetave në zonën nënujore me polubarë për 5 (pesë) agregatë".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Punë ndërtimi 45000000-7.

VLERA E FONDIT LIMIT: 240,000,000 (Dyqind e dyzet) milion lek pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor **Korporata Elektroenergjitike Shqiptare**, KESH sh.a ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

b. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8;*

Argumentimi:

Kriteret e mësipërme janë vendosur në përputhje me Nenin 82 “Formulari përmbledhës i vetë deklaratimit” dhe Neni 83 “Sigurimi i ofertës” të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në mbështetje të nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik, i ndryshuar. Në Nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, citohet: *“Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël”*, Neni 82, i LPP “1. Bashkë me dorëzimin e kërkesave

për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet Kontraktore pranojnë si provë paraprake në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetë deklaratimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme): me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetë deklaratimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 8.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, i ndryshuar, nenit 41, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

Operatori ekonomik duhet të ketë burime financiare të nevojshme për realizimin e objektit të prokurimit dhe merr përsipër çdo rrezik që mund të ndodhë, siç parashikohet apo nënkuptohet në kushtet e përgjithshme dhe të veçanta të kontratës. Në këtë kontekst, operatorët ekonomikë duhet të tregojnë se i përmbushin kushtet e mëposhtme:

2.2.1 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim nga administrata tatimore, për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që prokurohet (jo më e vogël se vlera e fondit limit).

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomike arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3 e LPP, i ndryshuar, si dhe nenin 43 pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në dispozitat e legjislacionit Nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar. VKM-së nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklaratimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike".

2.2.2 Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023 (*Bilancet të paraqiten konform parashikimit të nenit 41 shkronja c) të Ligjit nr. 1009/2009*), ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Kriteri konsiderohet i përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe Kreu V, Seksioni III, Nenit 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës,

ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

- Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

a) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9, shoqëruar me:
- Kontratë Sipërmarrje
- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore,
- Aktin e kolaudimit;

b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- Vërtetim lëshuar nga subjekti privat shoqëruar me:
- Kontrate Sipërmarrje;

- Situacionin përfundimtar;
- Faturat tatimore
- Akt kolaudimi objekti;

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50% të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë AK, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.

2.3.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për projektimin dhe zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, sipas formatit të miratuar me *VKM nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër.

Licenca profesionale e Operatorit Ekonomik lidhur me ekzekutimin e projektimit dhe punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

KATEGORITË NË FUSHAT E STUDIMIT DHE PROJEKTIMIT NË NDËRTIM

Kategoria 5 f – Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi– shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse

PUNIME TË PËRGJITHSHME NDËRTIMI

N.P – 6/A Diga dhe tunele hidroteknike;

N.P – 10/A Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.

Shënim : Në zbatim të nenit 39 "Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike", të VKM Nr. 285, datë 19/05/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Autoriteti Kontraktor lejon mundësinë që projektimi mund të nënkontraktohet, apo që ofertuesi (zbatuesi i punimeve) të paraqesë kontratë bashkëpunimi me subjekte që operojnë në fushën e projektimit dhe që plotësojnë të gjitha kriteret e hartuara nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë qëllim.

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, gjithashtu të dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore.

Konkretisht:

Kategoria 5 f – Vepra hidroteknike, galeri e tunele hidraulike, marrje uji, shkarkimi– shkarkues të ujërave të tepërta, vepra të marrjes së ujit nga rezervuarët, vepra të marrjes së ujit nga lumenjtë dhe marrja e ujit me puse.

HEC Vau Dejës është një vepër hidroteknike shume e rëndësishme, dhe projektimi i punimeve rehabilituese kërkon një ekspertizë inxhinierike konkretisht për projektimet për veprat hidroteknike. Sa më sipër operatori duhet të dëshmojë me licencimin përkatës sipas ligjit Shqiptar, që ka kapacitete për të realizuar projekte në vepra të marrjes së ujit.

N.P – 6/A Diga dhe tunele hidroteknike

Punimet për rehabilitimin e udhëzuesve të rrjetave të 5 agregateve në HEC Vau Dejës, konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, që janë të nevojshme për qarkullimin e ujit për çfarëdo lloj motivi, të lokalizuara në drejtim të rrjedhjes. Sa më sipër OE duhet të dëshmojë me licencimin përkatës sipas ligjit Shqiptar, që ka kapacitetet e nevojshme për realizimin e punimeve objekt kontrate.

N.P – 10/A Ndërtimi i impianteve për prodhimin e energjisë elektrike.

Veprat e Marrjes ne hidrocentrale konsiderohen ndërtime, mirëmbajtje ose ristrukturime me ndërhyrje të sakta, ose që janë të nevojshme për prodhimin e energjisë elektrike, të kompletuara me punimet e muraturës, plotësuese ose ndihmëse, të veçanta ose të rrjetit, përfshirë edhe të gjitha impiantet mekanike, elektromekanike elektrike, telefonike, elektronike, të nevojshëm për funksionim, sigurim dhe asistencë.

2.3.3 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij, për periudhën Prill 2024 – Qershor 2024

✚ 1 (një) inxhinier ndërtimi ose hidroteknik;

✚ 2 (dy) inxhinier mekanik;

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratë pune të vlefshme;
- ✚ Diplomën e inxhinierëve;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën periudhën Prill 2024 – Qershor 2024;
- ✚ CV;

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë **të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Konkretisht:

1 (një) inxhinier ndërtimi ose hidroteknik kërkohet pasi të vërtetohet se OE ka kapacitete njerëzore të specializuara për të ndjekur punimet rehabilituese në një vepër hidroteknike, që përbehet nga struktura B/A. Sipas natyrës së punimeve që do realizohen është kërkuar edhe profili i inxhinierit të ndërtimit ose hidroteknik.

2 (dy) inxhinier mekanik janë të nevojshëm pasi objekt i kësaj procedure janë punime mekanike për rehabilitimin e rrjetave të veprës së marrjes, udhëzuesëve të tyre, punime në konstruksione metalike etj. Për shkak të volumit të punimeve është e domosdoshme të jenë të paktën 2 inxhinier mekanik në mënyrë që të garantohet ndjekja e të gjitha volumeve të punimeve.

2.3.4 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij, për periudhën Prill 2024 – Qershor 2024 punonjësit teknik si më poshtë:

- ✚ 4 (katër) axhustatorë;
- ✚ 4 (katër) saldatorë;
- ✚ 4 (katër) specialist skelash;
- ✚ 4 (katër) specialist të punimeve në lartësi;
- ✚ 3 (tre) mekanike;

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratat e punës të vlefshme;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën periudhën Prill 2024 – Qershor 2024;
- ✚ Dëshmitë e kualifikimit të sigurimit teknik lëshuar nga institucionet e autorizuara me ligj (për axhustatorët, specialistet e skelave, specialistet të punimeve në lartësi dhe mekanikët) ;
- ✚ Certifikatat përkatëse ose ekuivalent (për saldatorët) ;

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë **të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Konkretisht:

4 (katër) axhustatorë janë kërkuar pasi : Axhustatorët janë të nevojshëm për arsye të pastrimit të tegelave të saldimit pas çdo kalimi dhe pastrimit përfundimtar të tegelit të saldimit. Rehabilitimi i rrjetave ka volume shumë të mëdha saldimi dhe është e nevojshme që OE të ketë në stafin e tij të paktën 4 axhustatorë për të garantuar realizimin e punimeve brenda afateve.

4 (katër) saldatorë janë kërkuar pasi: Rehabilitimi i rrjetave ndër të tjera do të ketë riparime të saldimeve, saldime të reja të elementeve që do të realizohen, etj. Pra procesi i saldimit do të jete prezent në çdo procedurë gjatë rehabilitimit, ndaj është e nevojshme praninë e saldatorëve.

4 (katër) specialist skelash janë kërkuar pasi: Segmentet e rrjetave pasi të jenë nxjerrë nga vepra e marrjes do pozicionohen në sheshin e kantierit dhe duke qenë se lartësia e tyre është e konsiderueshme është e nevojshme që të ndërtohen skela rreth tyre në mënyrë që të realizohen proceset e rehabilitimit. Duhet të theksojmë që secili agregat ka nga 5 segmente rrjetash dhe në këtë mënyrë volume i punës do të jete i konsiderueshëm, ndaj është e nevojshme që minimalisht të jenë 4 (katër) specialist skelash.

4 (katër) specialist të punimeve në lartësi janë kërkuar pasi: Specialistet e punimeve në lartësi kërkohen për arsye që të vërtetohet që OE ka kapacitete njerëzore të trajnuar për punime në lartësi, për të realizuar punimet në lartësi objekt i kësaj prokurimi. Punimet në lartësi do të ketë me skelat në rrjetat e agregateve, për manovrimet për lëvizjen e rrjetave me vinç, punimet në pusin e rrjetave.

3 (tre) mekanike janë kërkuar pasi: Elementet e segmenteve janë të gjitha me lidhje të çmontueshme me buloneri. Për këtë arsye është e nevojshme të jenë të pranishëm 3 (tre) mekanike për të realizuar demontimin e elementeve të vjetër dhe montimin e elementeve të rinj që do të furnizohen.

2.3.5 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij, për periudhën Prill 2024 – Qershor 2024 punonjësit si më poshtë:

- ✚ 1 (një) punonjës i certifikuar për kontrollet NDT, sipas standardit SSH UNI EN ISO 9712 ose ekuivalent;
- ✚ 1 (një) punonjës i certifikuar për sigurimin dhe shëndetin në punë;

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratat e punës të vlefshme;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën periudhën Prill 2024 – Qershor 2024;
- ✚ Certifikatat përkatëse;

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë **të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Konkretisht:

1 (një) punonjës i certifikuar për kontrollet NDT, sipas standardit SSH UNI EN ISO 9712 ose ekuivalent është kërkuar pasi : Procesi i rehabilitimit kërkon inspektimin e detajuar të konstruksionit të portave, veçanërisht nyjeve të salduara të cilat do të kontrollohen me metodat e kontrollit pa shkatërrim (NDT). Për këtë arsye është e nevojshme që të jetë minimalisht një specialist i fushës i certifikuar sipas standardit përkatës.

1 (një) punonjës i certifikuar për sigurimin dhe shëndetin në punë është kërkuar pasi : Referuar objektit te specifikimeve teknike, kemi të bëjmë me punime që kërkojnë respektimin në mënyrë të rreptë të sigurimit Teknik dhe shëndetit në pune. OE duhet të dëshmojë që ka në stafin e tij një person përgjegjës të certifikuar, që do të përgjigjet gjatë gjithë kohës së zbatimit të punimeve për sigurinë në punë.

2.3.6 Operatori Ekonomik duhet të ketë të punësuar në stafin e tij, për periudhën Prill 2024 – Qershor 2024 6 (gjashtë) polumbarë të certifikuar për zhytje në ujrat e embla nga të cilët 3 (tre) prej tyre të jenë të certifikuar si saldatorë sipas standartit SSH EN ISO 9606 -1 ose ekuivalent.

Në lidhje me kërkesën e mësipërme, gjatë ofertimit ofertuesi duhet të plotësojë në mënyrë të detajuar formularin përmbledhës të vetë deklaramit dhe më pas, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ofertuesi i kualifikuar i pari të paraqesë pranë Autoritetit Kontraktor, dokumentacionin i cili duhet të përputhet me atë të shprehur në formularin përmbledhës të vetë deklaramit si:

- ✚ Kontratat e punës të vlefshme;
- ✚ Listëpagesat e shoqërisë formulari E-sig, për periudhën periudhën Prill 2024 – Qershor 2024;
- ✚ Certifikatat përkatëse;

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë **të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore**, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Konkretisht:

Referuar objektit të specifikimeve teknike, punimet për rehabilitimin e udhëzuesëve të rrjetave për 5 (pese) agregatat në HEC Vau Dejës, do të realizohen nën ujë. Për të garantuar vazhdimësinë e punimeve gjate zbatimit të projektit OE duhet të ketë të paktën 2 (dy) grupe polumbaresh, me nga 3 (tre) polombarë secili grup për të zbatuar rregulloren e zhytjes. Përveç inspektimit dhe kontrollit të udhëzuesëve do të realizohen edhe saldime në pjesët që do të konstatohen të dëmtuara. Këto saldime do të realizohen nën ujë prandaj dhe është e domosdoshme që të paktën 3 (tre) nga polumbarët të jenë edhe saldatorë. Janë të nevojshme të formohen 2 (dy) grupe zhytje pasi koha e punës e polumbarëve është e kufizuar dhe me qëllim realizimin e punimeve në kohë është e nevojshme që të jenë 2 (dy) grupe polumbaresh në mënyrë që të realizohen orët e punës gjatë ditës.

2.3.7 Operatori Ekonomik duhet të jetë i çertifikuar sipas standartit SSH UNI EN ISO 9712 ose ekuivalent. Në lidhje me këtë pikë, Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse.

Argumentimi:

Kërkesa në lidhje me këto certifikata është në përputhje me nenin 44 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar dhe nenin 79 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Duke qene se rrjetat metalike janë te rëndësishme për sigurinë e punës se agregatit është e nevojshme që të garantohet cilësia e saldimeve dhe në këtë mënyrë të garantohet siguria e agregateve. Për ketë arsye është e nevojshme që OE të garantojë cilësinë e procedurave të saldimit.

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat ose ekuivalentet e tyre, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- a) ISO 9001- “Sistemi i menaxhimit të cilësisë”;
- b) ISO 14001- “Sistemi i menaxhimit të mjedisit”;
- c) ISO 45001- “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë”;

Argumentimi:

Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, “Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor” të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe nenin 39, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

ISO 9001- “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” - Ky standard është i nevojshëm për çertifikimin në realizimin e cilësisë, identifikimin e rrisqeve, caktimin e burimeve të nevojshme për të kontrolluar nëse mallrat e ofruar janë të cilësisë së duhur si dhe kontrollin e proceseve.

ISO 14001- “Sistemi i menaxhimit të mjedisit” - është e nevojshme që Kontraktori të ketë staf të vetëdijshëm për politikën mjedisore dhe pasojat e mundshme të aktiviteteve të tyre në mjedis. Aktivitetet e Kontraktorit duhet të jenë të tilla që të kontrollohet ndikimi në mjedis dhe të përgjigjet në rast emergjence të ndikimit në mjedis.

ISO 45001- “Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë” - është i nevojshëm për ndërgjegjësimin e gjithë personelit të shoqërisë në lidhje me masat e mbrojtjes së shëndetit, sigurisë dhe konsultimit të punësuarve për vlerësimin e rrisqeve të shëndetit dhe sigurisë në punë.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet të realizojë një vizitë në objekt për të inspektuar veprën e marrjes në HEC Vau Dejës në përputhje me pikën 2.17 Vizitë në kantier, të dokumenteve standarde të tenderit.

Argumentimi:

Duke marrë parasysh se kemi të bëjmë me një objekt shumë specifik, me punime të fshehta nënujore AK e shikon të domosdoshme vizitën në objekt përpara se të ofertohej. Kjo për arsyen se çdo OE i interesuar duhet të jetë i qartë për kushtet që do ketë për realizimin e punimeve.

Vizita në objekt është kusht i domosdoshëm, dhe vizita në kantier do të vërtetohet me një procesverbal sipas përcaktimeve në pikën 2.17 Vizitë në kantier, të dokumenteve standarde të tenderit.

2.3.10 Operatori ekonomik, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Mjetet /Pajisjet	Njësia	Sasia	Statusi
Pajisje speciale për prerje me elektroda karboni	Copë	2	Pronësi ose me qera
Furre tharje për elektroda	Copë	2	Pronësi ose me qera
Pajisje saldimi për elektroda	Copë	3	Pronësi ose me qera
Pajisje axhustimi në përmasa të vogla	Copë	6	Pronësi ose me qera
Pajisje për shpimin në metale	Copë	3	Pronësi ose me qera
Kamioncin vinç me kapacitet mbajtës deri në 10 ton	Copë	1	Pronësi ose me qera
Skeleri dhe platforma metalike të ndryshme	m2	100	Pronësi ose me qera
Pajisje hidraulike për prerje metalesh dhe axhustim nën ujë	Copë	2	Pronësi ose me qera
Pajisje për zhytje komplet	Copë	6	Pronësi ose me qera
Pajisje për pastrim rere	Copë	2	Pronësi ose me qera
Pajisje saldimi nën ujë	Copë	1	Pronësi ose me qera
Autovinç ose kamion me vinç me kapacitet ngritëse mbi 5 ton	Copë	1	Pronësi ose me qera

“Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8. “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, si më poshtë:

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike ne pronësi/qira do të paraqiten këto dokumente:

- Për pajisjet operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira të tij si psh, aktet e zhdoganimit ose faturë tatimore të shitblerjes orgjinale ose fotokopje e noteruar ose kontratë qiraje të noterizuar.
- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet dokumenti që vërteton pronësinë e mjetit. Kur janë në pronësi të paraqitet çertifikata e pronësisë, leja e qarkullimit, siguracioni i automjetit, certifikata e kontrollit teknik.
- Për mjetet e siguruar me qira, dokumentat e mësipërm duhet të shoqërohen edhe me kontratën përkatëse noteriale të qirasë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës objekt i këtij prokurimi.

Argumentimi:

Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe nenit 39, pika 6/ç dhe 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shënim: Në respekt të nenit 36, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, në të gjithë rastet në kur dokumentet e tenderit përmendet “markë” përfshihet termi “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Në rast të ofertave nga ofertues të huaj, dokumentet e ofertës duhet të jenë ekuivalente me dokumentet e kërkuara sipas parashikimeve ligjore të fushës për njehsimin e dokumenteve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Termat e referencës për “Rehabilitim i rrjetave metalike për 4(katër) agregatët në veprën e marrjes së Hec Vau i Dejës dhe rehabilitimi i udhëzuesve të rrjetave në zonën nënujore me polombarë për 5(pesë) agregatë” kanë qëllim kryesor rikthimin e kushteve të sigurisë në veprën e marrjes të HEC Fierzë për të garantuar operim normal të agregatëve në HEC Fierzë. Duke patur parasysh që punimet do të jenë në pjesën më fundore të veprës së marrjes të Vaut të Dejës që është në nivelin e ujit, punimet që do të realizohen janë shumë specifike që kërkojnë masa të veçanta të sigurimit Teknik. Referuar vizatimeve teknike të projektit të ndërtimit të HEC Vau Dejës dhe të dhënave të marra gjatë inspektimeve të ndryshme nga vetë KESH janë hartuar specifikimet për punimet që do të realizohen. Në këtë fazë nuk mund të përcaktohet me detaje shkalla e amortizimit të rrjetave dhe udhëzuesve të tyre për te 5 agregatet në HEC Vau Dejës .

Në këto kushte nuk mund të përcaktohen volumet e detajuara të çdo procesi pune, pasi do të kërkonte një inspektim të detajuar si dhe demontimin e elementëve përbërës të këtyre objekteve. Për të garantuar siguri në realizimin e punimeve janë kërkuar certifikime të polombarëve dhe saldatoreve sipas standardeve dhe normave teknike që përcaktojnë rregullat e zhytjes, dhe teknikat e saldimit.

Termat e referencës janë hartuar për kontratë me çelësa në dorë, për shkak të pamundësisë të hartimit të një projekti të detajuar, pasi kemi të bëjmë me objekt që ndodhet nën praninë e ujit. Në zbatim të Ligjit Nr. 162 datë 23/12/2020 "Për Prokurimin Publik", i ndryshuar, VKM Nr. 285, datë 19/05/2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, neni 39 pika b/ ii, Kur autoriteti kontraktor nuk ka hartuar projekt preventiv, por ka vetëm një projekt ide, apo detyrë projektimi dhe terma reference për objektin që prokuron. Në këtë rast, autoriteti kontraktor kërkon nga kontraktori hartimin e projekt preventivit, si dhe realizimin e punimeve të zbatimit të këtij projekti, pas miratimit paraprak të tij nga autoriteti kontraktor.

Njësia e Prokurimit